

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI I FILOLOGJISË
Dega e Letërsisë Shqipe

Kursi:
HYRJE NË ESTETIKË

Niveli dhe lloji i kursit: Bachelor / Kurs i obligueshëm
Viti i studimeve dhe semestri: Viti IV, semestri VII
Numri i orëve në javë: 2+2
Vlera në kredi ECTS: 5

Prof. asoc. dr. Kujtim Shala

Qëllimet e kursit:

Kursi **Hyrje në estetikë**, i ndërtuar si një histori e çështjeve themelore të estetikës, ka për qëllim që studentëve t'ua bëjë të njohura kategoritë, problemet, dilemat bazike të estetikës, si dhe një numër zgjidhjesh që ka dhënë ajo në shtrirje të shekujve.

Ky kurs ndjek autorët, sistemet, si dhe epokat e filozofisë së artit, gjithnjë duke synuar të lidhet me çështjet tipike. Qëllim themelor i tij mbetet krijimi i një pamjeje të përgjithshme të teorisë e të historisë së mendimit estetik.

Rezultatet e pritura:

Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studentët:

Do të kenë një pamje të çështjeve themelore të estetikës përgjatë rrjedhës së historisë së saj, të dilemave e të zgjidhjeve, si dhe të çështjeve që vijojnë të mbeten në hapura dhe pjesë e debatit bashkëkohor.

Do të mund të reflektojnë mbi dijen bazike të domenit të estetikës.

Do të mund të aplikojnë një numër parimesh të estetikës për interpretimin e veprave artistike, me përqendrim të veçantë te veprat letrare.

Metodologjia e mësimdhënies:

Ligjërata, ushtrime, detyra, diskutime

Literatura

1. Kujtim M. Shala: **Pro/Classica** (kapitulli *Poetika* e Aristotelit), Prishtinë, 2005
2. Daniel Herwitz: **Aesthetics - Key concepts in philosophy**, New York, 2008
3. **Aesthetics** (ed. by B. Gaut and D. M. Lopes), London and New York, 2005

4. Lyk Ferri: **Homo Aestheticus**, Tiranë, 2002
5. Zejnullah Rrahmani: **Letërsia e Mesjetës (Teoritë letrare)**, Prishtinë, 2003
6. Zejnullah Rrahmani: **Ligjërata mbi artin e Renesansës**, Prishtinë, 2004
7. Samuel Enoch Stumpf: **Filozofia - Historia & Problemet**, Tiranë, pa vit botimi
8. Leksione të shkruara

PLANI/PROGRAMI

Java e parë: Nocione të filozofisë

Java e dytë: Hyrje në estetikë (koncepte themelore)

Java e tretë: Estetika antike: autorë, shkolla e pikëpamje

Java e katërt: Teoria estetike e Platonit

Java e pestë: Teoria estetike e Aristotelit

Java e gjashtë: Mesjeta: estetika, teologjia, etika

Java e shtatë: Rilindja: estetika e ngushtuar

Java e tetë: Poetikat. Da Vinçi: estetika e pikturës
(Vlerësimi intermediar)

Java e nëntë: Estetika si fushë e diferencuar (Baumgarteni)

Java e dhjetë: Hyrje në estetikën klasike gjermane

Java e njëmbëdhjetë: Kanti e Hegeli - disa pikëpamje bazike

Java e dymbëdhjetë: Estetika pozitiviste

Java e trembëdhjetë: Niçe dhe estetika moderne

Java e katërmëdhjetë: Drejt një estetike letrare

Java e pesëmbëdhjetë: Estetika sot